



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika (i) të Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), nenit 15 dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 13.6.2024, merr këtë

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Kryeqytetit për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë me emrin e humanistit të madh, dr. Gani Demolli.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit, Drejtorja e Shëndetësisë dhe Drejtorja e Administratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb- faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-022/01-77925/24, më 18.6.2024

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Arsyetim

Dr. Gani Demolli gjatë vitit 1992, me idenë, iniciativën dhe angazhimin e pakursyer e themeloi Shërbimin Shëndetësor të Shoqatës, duke i mundësuar popullatës kosovare që të realizojë të drejtën për mbrojtje shëndetësore si njëren nga të drejtat themelore të njeriut. Ky Shërbim Shëndetësor, filloi me punë më 30 mars 1992. Fillimisht kishte 17 punëtorë shëndetësorë, që ofronin shërbimet e tyre në një ambulancë të vetme, me lokacion në lagjen "Kodra e Trimave" të Prishtinës.

Ishte një shërbim unik jo vetëm për Kosovën, por thuajse edhe për tërë botën, sepse vepronte mbi bazën e katër parimeve kryesore, të përcaktuara nga ideatori i tij, dr. Ganiu, e ato ishin: i tërë personeli i shërbimit (specialistët, mjekët, infermierët, punëtorët teknikë etj.) punonin mbi baza vullnetare, pa ndonjë kompensim financiar (pro bono); të gjithë pacientëve pavarësisht etnisë, moshës, gjinisë, fesë, racës iu ofroheshin kontrollet, ekzaminimet dhe shërbimet e tjera mjekësore pa pagesë (falas); parimi i tretë ishte se pacientët e Shërbimit Shëndetësor "Nënë Tereza" ishin të liruar nga çfarëdo lloj pagese për barnat, medikamentet dhe materialet tjera mjekësore që iu jepeshin për kurimin e tyre, dhe parimi i katërt ishte se, pronarët i kishin ofruar falas shtëpitë, objektet dhe lokalet e tyre për t'u shfrytëzuar si ambulanca mjekësore të Shërbimit.

Me kalimin e kohës, ky shërbim u rrit si nga numri i personelit ashtu edhe nga numri i ambulancave mjekësore, kështu gjatë gjithë ekzistimit dhe funksionimit të tij, nga 30 marsi 1992 deri me 24 mars 1999, në kuadër të këtij shërbimi kanë punuar 1665 personel mjekësor (afër gjysma e tyre ishin ish-studentë që kishin studiuar dhe diplomuar gjatë kohës kur objektet e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë, ishin të mbyllura për ta) dhe punëtorë teknikë (vozitës, mirëmbajtës etj.), të cilët i kanë ofruar shërbimet e tyre në 104 ambulanca mjekësore të "Nënës Terezë", anë e kënd Kosovës.

Sipas të dhënave të këtij shërbimi, gjatë periudhës 7-vjeçare të veprimtarisë së tij, qytetarëve të Kosovës, iu kishin ofruar rreth 4 milionë ekzaminime dhe trajtime të tjera mjekësore (injeksione, infuzione, lidhje me fasha, pastrime të lëndimeve etj.), si dhe në kuadër të maternitetit të këtij shërbimi (ishte funksionalizuar më 14.07.1996) kishin lindur afro 15 000 foshnje, pa asnjë rast të vdekjes qoftë të lehonave apo të foshnjave.

Prandaj, në nderim të kontributit të madh të dr. Gani Demollit dhe kujtimit të tij, Kryetari i Kryeqytetit i propozon Kuvendit të Kryeqytetit, që Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Prishtinë të emërtohet me emrin e humanistit të madh, dr. Gani Demolli.